



Acción Católica es misión  
L'Action Catholique, c'est la mission  
Catholic Action is mission  
Azione Cattolica è missione  
con tutti e per tutti  
II International Congress  
Rome | Vatican City | 27-30 April 2017

LIGJERATA E ATIT TE SHENJTE FRANÇESK  
PER PJESEMARRESIT NE KONGRES  
FORUMI NDERKOMBETAR I AKSIONIT KATOLIK (FNAK)

Salla e Sinodit  
E enjte, 27 prill 2017

Të dashur vëllezër e motra,

Ju përshëndes me rastin e kremtimit të këtj Kongresi ndërkombëtar të Aksionit Katolik, që ka si temë: "Aksioni Katolik në mision me të gjithë, për të gjithë". Do të më pëlqente të ndaja me ju disa shqetësime e konsiderata.

Do t'ju flas për karismen e AK, pastaj për disa linja veprimi, pastaj disa tema, cilët janë agjentët dhe përfituesit, për stilin që duhet të ketë AK dhe për projektin.  
Do t'i lejejoj vetes të dal nga tema sepse këto janë disa pika që më lejojnë them atë që ndjej, sa do të më ndihmonte t'i thoja në spanjisht, por te Sheshi do flas italisht<sup>1</sup>.

#### **Karizma – rikrijim nën dritën e Evangelii gaudium**

Karizma. Si mund ta riformulojmë karizmën në dritën e Evangelii Gaudium (EG)... EG është tabloja e referimit, tablo referimi e të gjithë veprimit apostolik sot në Kishë, ashtu siç ka qenë Evangelii Nuntiandi (EN) në kohën e vet, l'EN mbetet e vlefshme, është dokumenti më i mirë pas-koncilit që edhe sot vazhdon të tregojë rrugën e veprimit të Kishës. EG është një përkthim pak i azhurnuar, por ajo që është themelore qendron atje, tek EN: kjo është një detyrë drejtësie ndaj një dokumenti që nuk e ka humbur aktualitetin e vet. Si duhet riformuluar karizma nën dritën e EG në kontekstin e sotëm?

Historikisht Aksioni Katolik ka patur misionin e formimit të laikëve që merrnin përsipër përgjegjësinë e tyre në botë. Sot, konkretisht, është *formimi i dishepujve misionarë*. Faleminderit që e bëtë Evangelii gaudium- in kartën tuaj të madhe (Magna Carta).

Karizma e Aksionit Katolik është karizma e vetë Kishës së mishëruar thellësisht te e sotmja dhe te vendndodhja e çdo Kisha dioqezane që shquan në kundrim me vështrim të vëmendshëm jetën e popullit të vet dhe kërkon rrugë të reja ungjillizimi e misioni duke u nisur nga realitetet e ndryshme famullitare.

Nuk është një projekt konvertimi, sepse do të ishte kundër Ungjillit. Dhe këtu i bëj të miat fjalët e Benediktit XVI: "Kisha rritet jo me konvertime, por me tërheqje", më dhemb shumë kur shoh disa agjentë pastoralë, laikë të shuguruar, meshtarë, ipeshkëvinj që po përdorin konvertimin, ndërkohë që "tërheqja" është fjala gjeniale e Benediktit XVI që është si busull për rrugën tonë.

Aksioni Katolik ka patur tradicionalisht katër shtylla ose këmbë: *Lutjen, Formimin, Sakrificën dhe Apostullatën*. Sipas momentit të historisë së vet ka hedhur herë nje këmbë e pastaj të tjerat. Kështu, në një farë momenti, ajo që ka qenë më e forta ka qenë lutja ose formimi doktrinal.

Duke parë karakteristikat e momentit, apostullata duhet të jetë tipar dallues dhe është këmba që vendoset e para.

Nuk mohohen tre të tjerat, ama sfida e parë është dalja, një herë apostullata, pastaj vijnë të tjerat. Apostullata misionare ka nevojë për lutjen, formimin, sakrificën, ka nevojë për tre të tjerat, kur dalim e kuptojmë se, po nuk i patëm, puna që bëhet është sipërfaqësore e nuk jep fryt. Kjo del shumë qartë në dokumentin e Aparecida-s<sup>1</sup> që ka ndikuar shumë te EG – kam qenë atje dhe më është dashur ta studioj. Ka një dinamizëm integrues te misioni që nënkupton lutjen, formimin dhe sakrificën, por është misioni ai që integron, dalja.

Dhe kjo nuk i zbeh realitetet e tjera, por, në të kundërt, është ajo që i shkakton ato. Apostullata misionare ka nevojë për lutje, formim e sakrificë. Kjo del qartazi te Aparecida dhe te Evangelii Gaudium. *Te misioni ka një dinamizëm integrues.*

Çfarë ju kërkohet? Ju kërkohet të formoni, të formoni njerëz, burra e gra, të rinj e të reja....

*Formoni:* duke ofruar një proces rritje në fe, një ecje kateketike të vazhduar, të drejtuar nga misioni, të përshtatshëm për çdo realitet, duke u bazuar te Fjala e Hyut, për t'i dhënë jetë një miqësie të lumtur me Jezusin dhe një ekperience të dashurisë vëllazërore.

*Lutuni:* në atë hapjen e shenjtë ndaj të tjerëve që e vendos zemrën te nevojat e popullit, në vuajtjet e tij dhe në gëzimet e tij. Një lutje që të ecë, që t'ju çojë shumë larg. Kështu do shmangni ndenjen duke parë vazhdimisht veten tuaj.

Shmangeni atë lutjen e “përdredhur” që nuk të shtyn jashtë, që nuk është për misionin, që nuk mishërohet. Dhe lutuni shumë. Për disa është e mërzitshme lutja dhe ndonjëherë ashtu është. Shen Tereza e vogël është përgjumur disa herë para tabernakulit, ama është Shenjte, ulej para Jezusit e nuk lëvizte, e kjo Jezusit i pëlqen, kjo e bën zemrën më të fortë, e bën më apostolike....lutuni, duke shikuar nga misioni.

*Sakrifkohuni:* por sakrifkohuni jo për t'u ndjerë më të pastër; sakrifca më bujare është ajo që iu bën mirë të tjerëve. Ofroni kohën tuaj duke u munduar ç'të bëni që të tjerët të rriten, ofroni atë që keni nëpër xhepa duke e ndarë me ata që kanë më pak, ofroni bujarisht dhuntinë e vokacionit personal për ta zbukuruar e për ta rritur *shtëpinë e përbashkët*.

Është një test që zakonisht e bëj me fëmijët, me më të vegjlit: “ Nëqoftëse ke dy karamela e të vjen një shok, çfarë bën?” Ndonjëherë, shumë rrallë, përgjigja është: “ I fus në çantë për më vonë”; shumica thotë: “ Një e jap e një e mbaj”. Është mirë t'i ndash gjërat, për të mirën e të tjerëve. Pyetja e dytë: “Nëqoftëse ke një karamela dhe vjen një shoku yt, çfarë bën?”. “E ha me shpejtësi” më përgjigjet ndonjëri; të tjerët, shumica, përgjigjen: “E ndaj përgjysëm, gjysmën për vete e gjysmën për ty” dhe disa të tjerë, të paktë, më thonë: “ Ia jap shokut se unë e kam ngrënë një”.

Si janë lutja ime dhe sakrifca ime? Ruaj karamelen në çantë, e ndaj apo e heq nga vetja që të ketë tjetri? Sakrifca duhet jetuar në funksion të shërbimit, në funksion të ungjillizimit.

Nëqoftëse sot më kanë ftuar të vizitoj të moshuarit e një shtëpie pushimi dhe po qe se pikërisht sot është një ndeshje futbollit, një ndeshje e madhe që s'mund ta humb , në televizion, çfarë do bëj? Jini konkretë me pyetjet dhe me propozimet mbi sakrificën.

Sakrifca nuk mund të jetë sipërfaqësore appo narciziste, duhet të jetë si ajo e Jezusit që u angazhua për të tjerët, është e vetmja domethënie e krishterë e sakrificës: për të rinovuar detyrën e ungjillizimit.

**Rinovimi i detyrës së ungjillizuesit – dioqezë – famulli**

Kjo është një pikë shumë e qartë për mua: kohë më parë, gjatë një vizite pastorale si Papë, në një mbledhje me famullitarët, po me pyesnin cila ishte karizma e kongregatës – kishte dhe klerikë-së themeluar nga Shen Pjetri, pra të meshtarëve dioqezanë! Cila është karizma e priftit dioqezan? Përgjigjia ime ishte: Dioqezianiteti. Është e njëjta përgjigje që po ju jap juve. Cila është karizma e parë, detyra e parë ungjillizuese që qendron në karismën e AK, cili është angazhimi i parë ungjillizues i karizmës së AK? Dioqezianiteti, ose ndryshe të qenet pjesë e dioqezës. Me një kryetar. Ipeshkëvin.

Misioni nuk është një ndër detyrat te Aksioni Katolik, por është DETYRA. Aksioni Katolik ka karizmen për të çuar përpara aktivitetin baritor te Kishës. Nëqoftëse misioni nuk bëhet forca e tij dalluese, svanitet thelbi i Aksionit Katolik dhe humbet arësyeja e ekzistencës së tij.

Është me rëndësi jetike rinovimi dhe azhurnimi i impenjimit të Aksionit Katolik për ungjillizimin, duke mbrturur te të gjithë, në të gjitha vendet, në të gjitha rastet, në të gjitha periferitë eksistenciale, me të vërtetë, jo thjesht si formulim parimesh.

Më pëlqen ta përdor fjalën "periferi" sepse ato janë vendet më të rrezikshme të gjendjes sociale. Zakonisht mendojmë se periferia janë të varfrit, më të varfrit dhe pergjithësisht ashtu është. Por periferitë janë edhe mendimi, skeptikët,... A jam unë i gatshëm të arrij deri atje? të dëgjoj, të flas në periferitë e vështira? Kjo do të thotë të mbjellësh përsëri.

*Kjo nënkupton rimendimin e planeve tuaja të formimit, të formave tuaja të apostullatës e madje edhe të vetë lutjes suaj që të jeni thelbësisht, dhe jo rastësisht, misionarë.*

Jam misionar të shtunën, një çikë, po pastaj? Dhe ju të AK jeni misionarë thelbësisht dhe jo me raste. Edhe në situata të vështira e ndonjëherë të rrezikshme...

*Ta braktisim kriterin e vjetër: meqë kështu është vepruar gjithmonë. Ka gjëra që kanë qenë me të vërtetë të mira dhe të merituar, që sot do ishin jashtë konteksti po të donim t'i përsëritnim.*

Dhe këtu po ju them një fjali që s'duhet ta përdorim kurrë: "Gjithmonë kështu është vepruar". Kjo është një "shprehje e keqe". Duhet ndryshuar gjithmonë sepse ndryshojnë kohrat; ajo që është thelbësore nuk ndryshon kurrë: lajmi i Jezu Krishtit, qendrimi misionar, lutja, nevoja për t'u lutur, nevoja për t'u formuar, nevoja për t'u sakrifikuar....kjo nuk ndryshon, duhet menduar si duhet bërë. Shprehja "Kështu është bërë gjithmonë" ka bërë dhe i bën shumë dëm Kishës, ashtu si dhe "pandryshueshmëria", pra kur përcaktohen gjërat e nuk ke liri. Merrni kapitullin 23 të ungjillit të Shen Mateut e lexoni atë që Jezusi iu thotë "të pandryshueshmëve".

Kur në një dioqezë, në një famulli, në një qendër, në një grup të AK, vjen tundimi i "pandryshueshmërisë, lexojeni, ajo është çka Jezusi po ju thotë në atë çast. Fjala kyç që Jezusi iu thotë të pandryshueshmëve është "hipokritë"... Ndonjëherë duhet braktisur kriteri i vjetër sepse nuk shërben dhe të përdoret mesazhi dhe realiteti i AK me kriteret që sot janë të nevojshëm e që shërbejnë.

Aksioni Katolik duhet të vishet me tërësinë e misionit të Kishës me përkatësi bujare te Kisha dioqezane duke filluar nga Famullia.

AK nuk është satelit. Ju nuk jeni nga ato monadet kishëtare që ndonjëherë janë në Kishë- ... grupe që thonë " ne kemi përshpirtjen tonë, ne...", të mbyllura në vetvete e të përqendruar te vetja. Nuk është ky qendrimi i AK që e kanjë përkatësi. AK i përket dioqezës. Një AK që nuk është dioqezane – ndoshta

është një gjë e mirë- por nuk është AK. Një AK që nuk mishërohet te famullia nuk është AK. Kjo është e qartë edhe pse disa thonë: "Atë, më duket se famullia sikur ka dalë nga moda... "

Misioni i Kishës universale përditësohet në çdo Kishë të veçantë me ngjyrën e vet;po ashtu Aksioni Katolik fiton jetë të vërtetë duke u përgjigjur e duke e bërë të vetën pastoralen e çdo Kise dioqezane në futjen e tij konkrete, duke u nisur nga famullitë.

Çdo Kishë dioqezane ka një linjë pastorale, direktivat e Ipeshkëvit, të përpunuara me Këshillin Pastoral dhe AK futet në këtë linjë dhe mishërohet te famullitë. Famullia nuk ka dalë nga moda, do ketë mënyra të tjera për të qenë famulli... Kisha e ka kërkuar gjithmonë mënyrën. Famullia nuk ka dalë nga moda, thjesht sepse dioqezaniteti nuk ka dalë nga moda. Ipeshkëvi bëhet i afërt me popullin e Hyut përmes famullisë.

Aksioni Katolik duhet t'i ofrojë Kishës dioqezane një laikat të pjekur që t'iu shërbejë me gatishmëri projekteve pastorale të çdo vendi si një mënyrë për të realizuar vokacionin e vet. Duhet të mishëroheni konkretisht.

Duhet të mishëroheni në vendin ku jetoni; kjo është katolike. Herezinë e parë të Kishës e ka luftuar apostulli Gjon, ungjillshkruesi, sapo vdiq dhe u ringjall Zoti. Pas disa vitesh filloi herezia sipas së cilës fakti që Hyu u bë mish, është skandaloz. Gjoni është shumë i qartë këtu: kush e mohon se Fjala u bë mish është Antikrishti.

Nëqoftëse një lëvizje kishëtare nuk mishërohet në realitetin kishëtar të dioqezës, përmes famullisë, në mënyrën e saj të veçantë, rrezikon të hyjë në këtë linjën e të mosqenit i krishterë, që të mos themi që është Antikrishti. Kur hasim këto grupet e vogla që ushqehen në vetvete, edhe pse me shumë studim, por që jetojnë për vete.... mund të themi se janë" shenjtër heretikë skeptikë" ... por nuk janë katolikë.

Dhe një AK që pretendon të rrijë i mbyllur, që nuk mishërohet, duke ndjekur rrugët e Fjalës për të na shpëtuar, do të jete një aksion shumë i mirë, por nuk do të jetë katolik. Të mishëruar përgjithmonë! Por të mishëruar nuk do të thotë atje ku duam ne, po ku do Kisha, në dioqezë, në famulli.

Questo criterio dell'incarnazione non vale solo per l'inculturazione, che è l'altro aspetto dell'incarnazione, ma vale anche per l'organizzazione, per come si organizza la Chiesa.

Ky kriter i mishërimit nuk vlen vetëm për futjen në kulturën e tjetrit, që është një aspekt tjetër i mishërimit, por vlen edhe për organizimin, për menyrën e organizimit të Kishës.

Nuk mund të jeni si ato grupet *shumë universale* që nuk kanë bazë në asnjë vend, që nuk i përgjigjen askujt dhe shkojnë e kërkojnë atë që më shumë iu pëlqen në çdo vend.

Ato grupe janë orbitale, sillen rrotull brenda Kishës...është e vërtetë, jemi në epokën e sateliteve dhe, edhe Kisha i ka ato, por AK nuk duhet të jetë kështu. E keni të qartë? Nëse nuk i ngulni rrënjët, nuk mishëroheni në eralitetet konkrete dhe realiteti konkret është dioqeza, famullia...nuk është mirë. "Atë, por ekziston edhe AK universitar...". Sigurisht, mishërohuni atje, por gjithmonë nëpërmjet ipeshkëvit, jo në një grup që e ke krijuar ti. Dioqeza është kriteri i mishërimit. Famullia është një kriter i madh, një nivel tjetër mishërimi dhe kur ka vende të tjera më origjinale të kërkuara nga realiteti pastoral e që nuk janë në famulli, siç është pastoralja universitare, duhet të mishëroheni te Ipeshkëvi; Ipeshkëvi është i pazëvendësueshëm. Pa Ipeshkëvin nuk ka AK, pa dioqezanitet nuk ka AK.

Ndonjëherë mund të ndodhë te përsipirtshmëria, në disa kongregata rregulltarësh. Mbjaj mend një nënë të përgjithshme që donte ta ndryshonte kongregatën me sugjerime universale, një prej të cilave ishte që të mos shkonin në kapelë në mengjes për lutje, por të zhyteshin në natyrë. Tepër panteiste! Ndonjëherë ekziston një stil i pamishëruar, forma moderne të gnosticizmit, e kjo nuk ndihmon....

Konkretësia është një kriter që duhet ta keni, feja jonë është konkrete, Fjala u bë njeri (mish), konkretisht. Kur të shkojmë në qiell, do të na duhet të japim llogari për protokollin me të cilin do të gjykohejmë, shumë konkret, që gjendet te Mateu 25. Një protokoll shumë konkret. Kur themi lutjen

“BESOJ”, pohojmë gjëra konkrete, nuk ka asnjë pjesë të lutjes “BESOJ” që të mos jetë konkrete. Kur besimit i mungon konkretësia, ai nuk është katolik. A mund të priset konkretësia?. Po por ajo është një rrugë mëkati, që edhe ky është konkret.

Kërkoni te lutja “BESOJ” një pohim që të mos jetë konkret apo në kriteret e gjykimit universal diçka që Jezusi kërkon nga ne e që s’është konkrete. Kërkoni te Lumturitë, që janë projekt jete, diçka që s’është konkrete. Dhe nëqoftëse në fund të lumturive dikush mendon se bëhet fjalë për një rrugë ideale, Jezusi i mbyll ato në mënyrë shumë konkrete: lum si ju kur të persekutoheni, kur të gjykoheni, kur të flijoheni! Jezusi debon çdo iluzion mbi sofistifikimin e asaj që është katolike. E keni të qartë? Përkatësi, dioqezanitet, Ipeshkëvi, në përgjithësi famullia dhe, në rastin e një AK të specializuar, Ipeshkëvi është gjithmonë pikë referimi.

### Agjentët - Të gjithë pa përjashtim

Kush janë agjentët e AK?...Kryetari i grupit, sekretari, të ngarkuarit e niveleve të ndryshme...? Të gjithë.

Të gjithë antarët e Aksionit Katolik janë misionarë në dinamikë...

... Të gjithë janë agjentë. Aksioni Katolik është kjo dëshirë për të shkuar në mision.

Fëmijët ungjillizojnë fëmijët, të rinjtë të rinjtë, të rriturit të rriturit e kështu me radhe. Nuk ka më mirë se një i barabartë që të tregon se është e mundur të përjetosh gëzimin e besimit.

Mundohuni të mos bini në *tundimin e perfeksionistit të përgatitjes së përjetshme për mision dhe të analizave të përjetshme, që kur marrin fund kanë dalë nga moda ose janë tejkaluar.*

Sa arkiva të kurive dioqezane apo të instituteve fetare janë plot me plane pastorale që, kur mbaronin së përpunuari, kishin dalë nga moda...

Shembulli është ai i Jezusit me apostujt: i dërgonte me atë që kishin. Pastaj i mblidhte dhe i ndihmonte të reflektonin mbi atë kishin jetuar.

Kur Jezusi dëgoi 72 dishepujt ata nuk e kishin Denzigerin<sup>1</sup> nën sqetull. Kishin vetëm një eksperiencë të Jezusit, njihnin thelbësoren e mesazhit të krishterë, njihnin lumturitë dhe ktheheshin për të treguar se me ato pak që kishin edhe demonët dorëzoheshin. Është forca e predikimit, forca e dëshmisë me ato që kemi në atë moment apo që janë të nevojshme në atë moment.

Le të jetë realiteti ai që ju dikton kohën, i lejofshi Shpirtit të Shenjtë t’ju udhëheqë. Ai është Mesuesi i brendshëm që ndriçon veprat tona kur jemi të lirë nga paragjykimet e kushtëzimet. Duke ungjillizuar mëson si të ungjillizosh, ashtu si duke u lutur mëson si lutesh, nëse zemra jote hështë e hapur.

Të gjithë mund të shkoni në mision edhe pse, jo të gjithë mund të dilni rrugëve e fshatrave. Është shumë i rëndësishëm vendi që iu jepni personave të moshuar që janë antare prej shume kohësh apo që inkorporohen. Mund të thuhet: mund të jenë seksini kundrues dhe ndermjetësit brenda grupeve të ndryshme të Aksionit Katolik. Janë ata që mund ta krijojnë pasurinë e lutjes dhe hirit për misionin. Ashtu si dhe të sëmurët. Këtë lutje Hyu e dëgjon me nrohtësi të veçantë. U ndjefshin të gjithë ata pjesëmarrës, u zbulofshin aktivë e të dobishëm.

Duhet të bëjmë një AK për çdo situatë të veçantë? Përfshijini të gjithë, të gjithë e kanë një mision në botë, e, nëse keni një zemër ungjillizuese, mund t’i fusni të gjithë e secilin.

Këtu dua të ndalem akoma mbi një pikë që e kam për zemër prej pak kohësh: të moshuarit. Jetojmë në një kulturë të hedhurinave, ku mbizotëron filozofia "Perdor e hidh"; kur diçka nuk funksionon apo nuk prodhon, hidhet. Kështu të moshuarit mbrijnë deri në njëfarë pike e pastaj hidhen mënjanë, nuk shërbejnë....Eshhtë e modës t' heqësh qafe... ndonjëherë mjafton një shtrim për sëmundje apo për kujdesje të veçanta, kërkohet një azil dhe i lemë atje. Në këtë mënyrë hedhim një pasuri të familjes.

Edhe të rinjtë hidhen sot...po ju jap një shembull, papunësia. Këtu në Itali janë të papunë 40% e të rinjve nën 25 vjeç, 47% në Kroaci, në Spanjë më duket mbrijnë në 50% e kështu në të gjitha shtetet e Europës. E pse? Sepse nuk shërbejnë, nuk ka punë e i hedhin. Nuk është se hidhen me të vërtetë, por, në fakt, çfarë bën një i ri papunë? Sëmuret ose vret veten (është shqetësuese të shohësh statistikat mbi vetëvrasjet rinore)... ose bie në drogë apo mobilizohet me terrorizmin apo me kriminalitetin duke kërkuar një ideal, diçka për të bërë.

Edhe fëmijët hidhen sepse nuk merren parasysh, përjashtoj rastet kur janë shumë inteligjentë dhe iu kërkohet një shkollë e posaçme dy gjuhëshe apo trigjuhëshe që një ditë të bëhen drejtues, Cdo gjë bëhet gjithnjë e më e vogël, si një hinkë, skartohen gjithnjë e më shumë njerëz për t'i dhënë formë kësaj hinke.

Sot besoj se është i rëndësishëm dhe jua besoj si detyrë, dialogun e femijeve më të vegjel me personat e moshuar dhe ia besoj Ak veçanërisht si detyrë që të gjejë mënyrën ta bëjë në famulli. Nuk kalon çdo gjë nga kjo zgjedhje po gjejini mënyrën.

Kur lutem me veprën e Joelit 3.1, prekem shumë, një nga shenjat e mbertërisë është që të moshuarit do rifillojnë të ëndërojnë e të rinjtë do të profetizojnë.

Do të profetizojnë e do të realizojnë, do të shpien para ëndrat e të moshuarve. Ne ua kemi hequr të moshuarve aftësinë për të ëndëruar sepse janë të mërzitshëm, sepse nuk na ndihmojnë, dhe të rinjve iu kemi prerë rrënjët.

Kjo është me të vërtetë diçka urgjente e besoj se Shpirti sot i kërkon Kishës që ta ndihmojë këtë dialog, që fëmijët t'u afrohen të moshuarve, t'u bëjnë atyre pyetje, t'i bëjnë të flasin dhe e gjitha kjo do të japë frut në zemrën e një fëmije, do të jetë një profeci që do mundohen ta realizojnë, ta çojnë përpara e do të jetë një rinovim. Nuk mund të jepet frut nëse rrënja është shumë e dobët apo nuk ekziston, është e thatë.Dhe ne po i presim rrënjët.

**Jua besoj seriozisht këtë detyrë.** Duke patur parasysh që të gjithë mund ta bëjnë e që ky dialog është i rëndësishëm. E kam parë në disa kisha të veçanta: grupe të rinjsh fillojnë të shkojnë në rezidenca të moshuarish, në spitale, t'i bien kitarës, të këndojnë me të moshuarit e pastaj fillojnë e flasin dhe e kuptojnë se duhet të kthehen, se aty është një pasuri, që duhet ushqyer. Jua rekomandoj në mënyrë të veçantë.

### **Të destinuarit - Të gjithë njerëzit e të gjitha periferitë.**

Eshtë e nevojshme që Aksioni Katolik të jetë i pranishëm në botën politike, të ndërmarrjes, profesionale, jo se e mbajmë veten për të krishterë të persosur e të formuar, por për të shërbyer më mirë.

Eshtë e domosdoshme që Aksioni Katolik të jetë i pranishëm në burgje.

Përfshirë ato me të denuar të perjetshem,sepse çdo i dënuar ka nevojë për një horizont, jo për hekura apo për mure... AK mund të japë horizonte, të punojë për rifutjen në jetë.

*në spitale, në rrugë, në lagjet me kasolle, në fabrika.* Po të mos jetë kështu, do të jetë institucion përjashtuesish që nuk i thonë asgjë askujt, as vetë Kishës.

Në këtë pikë jini rigorozë: konkretësi. Impenjim konkret në periferitë më konkrete. Do ju trejoj një anekdotë për një periferi konkrete, të vështirë.

E ka bërë një ipeshkëv, por të gjithë mund ta ndjekin si shembull.

Në dioqezën e tij mbahej një manifestim i organizuar nga një i ri, një manifestim kundër Kishës, një farë procesioni. .. Në vend që të këndoheshin këngë procesioni, këndonin gjëra shumë të forta kundër Kishës, kundër Papës dhe ipeshkëvinjve, edhe me gjeste vulgare, ofendime e blasfemi.

Ipeshkëvi pa që aty ishte një periferi, u informua kush ishte kreu i saj, dhe pasi u lut, e mori në telefon dhe pas ca ditësh e ftoi për kafe. Kuptohet, kreu nuk u bë katolik, nuk i tha ipeshkëvit të rrefeje e nuk kërkoi kungimin, por folën për gjyshin, për gjyshen, kujtuan rrënjët e tij. Ajo që bëri ai ipeshkëv, duke shkuar në periferi, është një model i asaj që AK duhet të bëjë. Të mos ketë frikë nga asgjë. As nga ata që të rrinë përballë në rrugë e që çfarë s'të thonë. Prandaj duhet të lutemi, të kërkojmë dritë, t'i kërkojmë ndihmë Shpirtit të Shenjtë për të bërë hapin e nevojshëm.

Cfarë t'i kërkoj AK?

Dua një Aksion Katolik në mes njerëzve, në famulli, në dioqezë, në fshat, në lagje, në familje, në studim e në punë, në ambientet e jetës. Në këto gjykata të reja merren vendimet e ndërtohet kultura.

*T'i mprehim mënyrat e futjes.* Mos u bëni dogana. Nuk mund të jeni më kufizues se vetë Kisha, as më papistë se Papa. Hapini dyert, mos bëni provime të përsosmërisë së krishterë sepse kështu do të çoni para një fariseizëm hipokrit. Ka nevojë për mëshirë aktive.

*Imepenjimi që marrin laikët që marrin pjesë te Aksioni Katolik sheh përpara.* Eshtë dëshira për të punuar për ndërtimin e mbretërisë. Nuk duhet "Brokratizuar" ky hir i veçantë sepse ftesa e Zotit vjen atëherë kur s'e presim; por as nuk mund ta "shenjtërojmë" zyrtarizimin me kërkesa që i përgjigjen një ambienti tjetër të jetës së fesë dhe jo asaj të Impenjimit ungjillizues. Të gjithë kanë të drejtë të jenë ungjillizues. Aksioni Katolik le t'iu ofrojë hapsirën e pritjes dhe eksperiencës së krishterë atyre që, për motive personale, ndjehen "Të krishterë të dorës së dytë".

Në ç mënyrë mund ta bëjmë këtë?

### **Mënyra – Ne mesin e popullit**

Kur them "popull", mund të ngatërrohet me fjalën popullizëm, por unë iu referohem njerëzve, popullit të Hyut. Mund të flitet për Popullin si për një ide, një kategori logjike e atëherë flitet për popullizma, ose ideologjikisht, për shtresa popullore. Populli, ama, është një kategori mitike, populli është populli, janë njerëzit. Në ungjill shohim "turmën" që ndiqte Jezusin, e ndiqnin njerëzit... dishepujt, sigurisht, ama gjithmonë njerëzit, populli...sepse iu pëlqente, përveç faktit që shëronte të sëmurët, iu pëlqente mënyra e tij e të folurit, me autoritet...

Mënyra varet nga të destinuarit. Siç na ka thënë Koncili dhe lutemi shpesh në Meshë: të vëmendshëm dhe duke marrë pjesë në betejat dhe shpresat e njerëzve për t'iu treguar atyre udhën e shpëtimit. Aksioni Katolik nuk mund të qendrojë larg popullit dhe duhet të rrije ne mes të popullit. Duhet ta popullarizoni më shumë Aksionin Katolik.

Po kjo ç'do të thotë? Që duhet të shkojmë të kërkojmë njerëz që nuk bëjnë pjesë te elita e shoqërisë? Jo, nuk e them në kuptimin sociologjik sepse ajo është ideologjia e popullit. E them në kuptimin mitik. Duhet ta bëni Aksionin katolik më shumë të popullit të shenjtë e besnik të Hyut.

Nuk është çështje imazhi por vërtetësie dhe karizme. Nuk është as demagogji, por është ecje ne gjurmët e Mesuesit i cili nuk provoi neveri për asgjë.

Që të mund ta ndiqni këtë rrugë është mirë të laheni ne detin e popullit. Te merrni pjesë në jetën e njerëzve dhe të mësoni të zbuloni cilat janë interesat e tij dhe kërkimet, cilat janë dëshirat e tij dhe

plagët më të thella; dhe çfarë ka nevojë prej nesh. Kjo është themelore për të mos rënë në sterilitetin e dhenis së përgjigjeve ndaj pyetjeve që askush nuk i bën.

Cilat janë pyetjet që bën ky popull? Cila është pyetja që i bëjnë vetes këta njerëz? Përgjigjet e mia duhet të jenë frut i një pyetje reale sepse ndonjëherë shkojme me fjalimin e përgatitur dhe rrezikojmë t'iu japim përgjigje pyetjeve që askush nuk na bën. Ky qëndrim është themelor për të mos rënë në sterilitet.

Mënyrat e ungjillimit mund të mendohen nga një tavolinë pune, por vetëm pasi kemi qenë në mes të popullit, e jo e kundërta.

Vai, cammina, tieni contatti concreti, dopo sì, siediti alla scrivania e fai il piano pastorale, così può andare bene...

Ik, ec, mbaj kontakte konkrete, pastaj po, ulu në tavolinë dhe bëj planin pastoral, kështu po....

Një Aksion Katolik më popullor, më i mishëruar, *do ju shkaktojë probleme*, sepse do duan të bëjnë pjesë në këtë institucion persona që në dukje nuk janë në gjendje ta bëjnë: familje ku prinderut s'jane martuar ne kisha, burra e gra me nje te kaluar apo të tashme të vështirë por që luftojnë, të rinj të dizorientuar e të plagosur. Është një sfidë për *amësinë kishtare* të Aksionit Katolik; t'i mirëpresë të gjithë e t'i shoqërojë në rrugën e jetës me kryqet që mbajnë mbi supe. Të gjithë mund të marrin pjesë duke filluar nga *ajo që kanë e nga ajo që munden*. Për këtë popull konkret formohemi. Me këtë e për këtë popull konkret lutemi.

Mpreheni shikimin për të parë *shenjat e Hyut të pranishme në realitet, veçanërisht në shprehjet e religjiozitetit popullor*. Që aty mund ta kuptoni më mirë zemrën e njerëzve dhe do të zbuloni mënyrat habitëse me të cilat Hyu vepron përtej koncepteve tona.

Ka një dije te njerëzit vullnetmirë, te njerëzit që e fitojnë bukën çdo ditë për fëmijët e tyre. Ka shumë tunfime e ka shumë mëkat, ama ka shumë dituri që mund të na mësojë shumë. Mbaj mend njëherë që, duke rrefyer një natë në Lujan, një natë shtegëtimi, ishte në radhe një i ri 22-23 vjeç, i madh, flokë të gjata, pirsing në hundë, shëndetplotë. Ishte punëtor i specializuar, i biri i një gruaje pa burrë, që pastronte shtëpiteme orë në vende të ndryshme. Kjo grua e kishte bërë të studjonte të birin që kishte ndjekur shkollën teknike dhe ishte bërë punëtor i specializuar. Ky djalosh ishte futur në një situatë të ngatërruar dhe kishte filluar të ndjente shumë angushti e një ditë flet me të ëmën e cila i thotë: "dëgjo, biri im, pas ca ditësh është shtegëtimi në Lujan, ik e pyet Virgjërën Mari çfarë duhet të bësh". Kjo është dituria. "Po ti çfarë bërë?" e pyeta e ai m'u përgjigj: " Ndenja me Virgjërën – dhe i kishte syte e lagur sepse kishte qarë- ndenja atje para Virgjërës e tani do bëj këtë, këtë ..." Dituria e njerëzve. E ema nuk dinte çfare duhet të bënte i biri, ama i kishte treguar ku të shkonte. Ka shumë dituri te populli ynë, shumë dije që duhen integruar.

Mpreheni shikimin për t'i parë shenjat e Hyut të pranishme kudo në realitet.

### **Projekti – Aksioni Katolik në dalje Pasion për Krishtin, pasion për popullin tonë.**

Dje lexuam ungjillin e Markut, në të cilin Jezusi na thotë të shkojmë, të dalim.... Ndonjëherë e konceptojmë Kishën si një gjënë tonë, të mbyllur mirë. Te Zbulesa Jezusi thotë: "jam te der e po trokas" ... " e nëse dikush ma hap derën unë do shkoj te ai e do ha darkë me të" ( shih Zb. 3,20)... Kërkon të hyjë në zemrën tonë...ama, sa herë në kishat tona të veçanta Jezusi troket te dera nga brenda që ta lemë të dalë. Një AK me dalje, për dalje jashtë, në rrugë, dhe kjo, insistoj, nuk do të thotë konvertim.



## **Pasion për Krishtin, pasion për Popullin tonë.**

I keni propozuar vetes një Aksion Katolik me dalje, dhe kjo është një gjë e mirë sepse ju vendos mbi boshtin tuaj. Dalje do të thotë hapje, bujari, takim me realitetin përtej katër mureve të institucioneve e të famullive. Kjo do të thotë *të heqësh dorë nga kontrolli i tepërt i gjërave dhe nga programimi i rezultateve*. Është kjo liri, që është frut i Shpirtit të Shenjtë, që do t'ju bëjë të rriteni.

Projekti ungjillizues i Aksionit Katolik duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm: PRIMEREAR, dmth të marrësh iniciativën, të marrësh pjesë, të shoqërosh, të frutifikosh e të festosh. Një hap para drejt daljes, të mishëruar e duke ecur së bashku. Ky është tanimë një frut që duhet festuar. *Ngjituani të tjerëve gëzimin e fesë, të vihet re gëzimi i ungjillizimit në çdo rast, të përshtatshëm ose jo.*

Mos bini në tundimin e strukturalizmit. Jini guximtarë, nuk jeni më besnikë ndaj Kishës nëse prisni në çdo hap që t'ju thonë çfarë duhet të bëni.

Ju lutem mos jini nga ata që nuk bëjnë sepse nuk kanë kërkuar lehtë e nuk gjejnë kujt t'ia kërkojnë. Ndonjëherë është më mirë të kërkojë falje më pas, sesa të kërkojë lehtë më parë, por të bësh...

Inkurajojini antarët tuaj ta vlerësojnë misionin trup me trup rastesor duke filluar nga aksioni misionar i komunitetit.

Dhe ju lutem, kjo po, është një temë serioze që më shqetëson: **Mos klerikalizoni laikët!**  
Misioni i Shpirtit të Shenjtë qëndron te sakramenti i parë që marrim të gjithë si laikë, pastaj Shpirti mund të na thërrasë në drejtime të tjera. Mos e klerikalizoni laikun, ky është një tundim shumë i madh.  
Më ka ndodhur disa herë ( të paktën tre herë në dioqezën time) që vjen një famullitar e më thotë se ka një laik fenomenal që bën këtë e atë e unë i them " Sa mirë, sa organizator i mirë" e ai me pyet: Si thua, a e bëjmë diakon?" Mos ia jepni ju vokacioni. E bën Shpirti i Shenjtë këtë. Mos klerikalizoni...

Pagëzimi është hapi i parë, por në Kishën e origjinës ekzistonte një dallim shumë i qartë. Kur helenistët shkuan të ankoreshin te apostujt se vejushat e jetimët e tyre nuk ndiqeshin mirë, apostujt bënë një koncil të vogël, dhe gjatë kësaj mbledhje, "shpikën" diakonët dhe kërkuan shtatë burra me vlerë për t'iu ngarkuar atyre detyrën e vejushave, jetimëve e gjërave materiale – Roma ka një diakon të shquar, që ishte ekonomisti i dioqezës, martiri Lorenc- dhe Pjetri kur ua shpjegoi atyre këtë zgjedhje, iu tha duke e mbyllur: " Dhe ne ipeshkëvinjtë, merremi me lutjen e lajmërimin e Fjalës". Detyra e parë e ipeshkëvit është lutja dhe e dyta, bashkë me lutjen, është lajmërimi i Fjalës...Por po iu flas laikëve të AK, duket sikur po flas me nusen që të dëgjojë vjehrra, apo jo!

*Mos e klerikalizoni laikun.* Aspirata e antareve tuaj të mos jetë pjesëmarrja në sindrin e famullive që rrethon famullitarin por pasioni për mbretërinë. Mos harroni ama ta përmendni temën e vokacionit me seriozitet.

Është temë serioze....vokacion në kuptimin e gjerë e në kuptimin veçanërisht të konsakrimit në shërbim të Zotit në meshtari apo në jetën e shuguruar...

Shkollë shenjtërie që kalon detyrimisht nga zbulimi i vokacionit tonë, që nuk është të qenët drejtues apo prift i diplomuar, por para së gjithash, *ungjillizues*.

Duhet të jeni vend takimi për pjesën e mbetur të karizmave institucionale e të lëvizjeve që janë në Kishë pa patur frikë se e humbni dinjitetin. Përveç kësaj, mes antarëve tuaj duhet të dalin ungjillizuesit, katekistët, misionarët, punonjësit socialë që do të vazhdojnë ta rritin Kishën.

Shumë herë është thënë se Aksioni Katolik është Krahu i gjatë i hierarkisë dhe kjo, larg të qenit privilegj që të ben t'i shohësh të tjerët nga lart-poshtë, është përgjegjësi shumë e madhe që nënkupton besnikëri e koherencë me atë që Kisha tregon në çdo moment të historisë pa pretenduar të qendrosh i lidhur me forma të shkuara sikur të ishin të vetmet zgjidhje të mundshme. Besnikëria ndaj misionit e kërkon këtë “plasticitet të mirë” të atij që e ka një vesh nga populli e një nga Zoti.

Në botimin “ La Accion Catolica a luz de la teologia Tomista” të vitit 1937, lexojmë: “ndoshta Aksioni Katolik mund të përkthehet në **Pasion Katolik?**”.

Në vitin 1937, kur unë isha 1 vjec....Ju pyes ju: “Aksioni Katolik a nuk duhet të shndrohet më shumë, pa reshtur së qeni Aksion, në Pasion Katolik?”
--

Pasioni katolik, pasioni i Kishës është të jetuarit e gëzimit të ëmbëll e qetësues të ungjillizimit.

Kjo është ajo për të cilën kemi nevojë nga Aksioni Katolik.

Faleminderit.